



**REPUBLIKA E KOSOVËS -PRESIDENTI**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNIK**

---

**RREGULLORE (P) NR. 02/2019 PËR CEREMONINË E  
BETIMIT TË PROKURORËVE**

**Prishtinë, 24 qershor 2019**



**REPUBLIKA E KOSOVËS -PRESIDENTI**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO - PREDSEDNIK**

---

Presidenti i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 84 pika (18) dhe nenit 109 (5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), nenit 24 (4) të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (GZ, Nr. 10, 3 prill 2019) dhe nenit 3 (4) të Rregullores (P) Nr. 02/2016 për strukturën organizative të Presidencës (08.09.2016), miraton:

**RREGULLORE (P) NR. 02/2019 PËR CEREMONINË E BETIMIT TË  
PROKURORËVE**

**KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton procedurat në Presidencë, për emërimin e prokurorëve me mandat fillestar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe organizmin e ceremonisë së betimit të tyre para Presidentit.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet nga njësitë përkatëse në Presidencë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, kandidatet e propozuar për prokuror me mandat fillestar dhe pjesëmarrësit tjerë në ceremoninë e betimit të prokurorëve.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
  - 1.1. **President** – Presidenti i Republikës së Kosovës;
  - 1.2. **Presidencë** – selia e aktivitetit zyrtar të Presidentit, që përfshin Kabinetin e Presidentit, Zyrën e Presidentit dhe institucionet/njësitë tjera të ndërlidhura;
  - 1.3. **Departament** – Departamenti për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
  - 1.4. **Ligj** – Ligji Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (GZ, Nr. 10, 3 prill 2019);
  - 1.5. **Kushtetutë** – Kushtetua e Republikës së Kosovës;

- 1.6. **Këshill** - Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- 1.7. **Kandidat** – kandidati i propozuar nga Këshilli për t'u emëruar prokuror me mandat fillestar tre (3) vjeçar.

## **KAPITULLI II - EMËRIMI I PROKURORIT ME MANDAT FILLESTAR**

### **Neni 4 Propozimi për emërim**

1. Këshilli pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit, i dërgon Presidentit propozimin e kandidatit për t'u emëruar prokuror.
2. Propozimi nga paragrafi një (1) i këtij neni përmban:
  - 2.1. shkresën e Këshillit drejtuar Presidentit, për emërimin e kandidatit, të nënshkruar nga Kryesuesi i Këshillit;
  - 2.2. raportin me shkrim për procesin dhe kandidatin, të nënshkruar nga Kryesuesi i Këshillit;
  - 2.3. vendimin e Këshillit, të nënshkruar nga Kryesuesi i Këshillit; dhe
  - 2.4. kopjen e dokumentit të identifikimit të vlefshëm me fotografi të kandidatit.

### **Neni 5 Shqyrtimi i propozimit**

1. Propozimi i Këshillit, pas pranimit të tij në Presidencë, i përcillet Kabinetit të Presidentit për njoftim dhe Departamentit për shqyrtim.
2. Zyrtari përgjegjës i Departamenti shqyrton propozimin e Këshillit për emërimin e kandidatit, dhe nëse propozimi:
  - 2.1. nuk është i kompletuar dhe nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, kërkon plotësimin e tij dhe për këtë e njofton edhe Kabinetin e Presidentit;
  - 2.2. është i kompletuar në pajtim me legjislacionin në fuqi, përgatit opinionin ligjor dhe propozim dekretin, të cilat përmes Drejtorit të Departamentit dërgohen për nënshkrim tek Presidenti.

### **Neni 6 Emërimi i prokurorit**

1. Presidenti nxjerr Dekret për emërimin e kandidatit për prokuror, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, pas pranimit të propozimit të kompletuar nga Këshilli.
2. Nëse brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, Presidenti nuk e emëron prokurorin, Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj, Presidenti emëron prokurorin sipas propozimit të Këshillit.

## **KAPITULLI III - CEREMONIA E BETIMIT TË PROKURORIT**

### **Neni 7**

#### **Organizimi i ceremonisë së betimit**

1. Ceremonia e betimit të prokurorit është ceremoni publike para Presidentit, nëse Presidentit nuk vendos ndryshe.
2. Pas nxjerrjes së Dekretit nga Presidenti për emërimin e prokurorit, Departamenti ndërmerr veprimet e nevojshme për organizimin e ceremonisë së betimit për prokuror.
3. Departamenti, në bashkëpunim me Departamentin e Protokollit dhe në konsultim me Kabinetin e Presidentit, cakton vendin, datën dhe orën e ceremonisë së betimit për prokurorin e emëruar, si dhe përgatit listën e pjesëmarrësve, që do të ftohen në ceremoni.

### **Neni 8**

#### **Njoftimi**

1. Departamenti, njofton Këshillin për vendin, datën dhe orën e ceremonisë së betimit për prokuror si dhe për kodin e veshjes.
2. Këshilli njofton kandidatin, për:
  - 2.1. vendin, datën dhe orën e ceremonisë së betimit; dhe
  - 2.2. kodin e veshjes.
3. Departamenti, fton pjesëmarrësit tjerë në ceremoninë e betimit të prokurorit nga lista e përgatitur në pajtim me nenin 7.3. të kësaj Rregulloreje.

### **Neni 9**

#### **Përgatitjet për ceremoninë e betimit**

1. Departamenti i Protokollit, për ceremoninë e betimit për prokuror, përkujdeset për:
  - 1.1. rezervimin dhe rregullimin e vendit;
  - 1.2. pritjen dhe vendosjen e të ftuarve, sipas rregullave protokollare;
  - 1.3. paraqitjen dhe veshjen sipas kodit të veshjes dhe
  - 1.4. çështje tjera protokollare.

### **Neni 10**

#### **Udhëzimet për procedurat e ceremonisë së betimit**

Para fillimit të ceremonisë së betimit, zyrtari i Departamentit, e udhëzon prokurorin për procedurën e ceremonisë së betimit dhe pjesëmarrësit tjerë.

### **Neni 11**

#### **Ceremonia e betimit**

1. Gjatë ceremonisë së betimit:
  - 1.1. prokurori ka një dosje para veti, që brenda ka tekstin e betimit në dy kopje;
  - 1.2. të gjithë të pranishmit ngritën në këmbë;
  - 1.3. prokurori ngrit dorën e djathtë lartë me shuplak të hapur;
  - 1.4. Presidenti, e lexon tekstin e betimit;

- 1.5. prokurori pas përfundimit të leximit të tekstit të betimit nga Presidenti, më zë të lartë thotë: Beto hem;
  - 1.6. pas dhënies së Betimit, Presidenti, prokurori dhe pjesëmarrësit tjerë ulen;
  - 1.7. prokurori i nënshkruan dy kopje të tekstit të betimit, njëri mbetet në Presidencë dhe
  - 1.8. në përfundim të ceremonisë së betimit, Presidenti i dorëzon prokurorit dekretin për emërim.
2. Prokurori me nevoja të veçanta, betimin para Presidentit mund ta bëjë duke ju përshtatur nevojave dhe kërkesave specifike, ku në këto raste Këshilli duhet të njoftoj paraprakisht Presidencën.
  3. Prokurori i sapoemëruar merr detyrën e prokurorit pasi të ketë dhënë betimin para Presidentit.

### **Neni 12 Informimi**

Presidenca, informon publikun për emërimin dhe betimin e prokurorit përmes ueb-faqes zyrtare të Presidencës apo formave të tjera.

### **Neni 13 Konfidencialiteti**

1. Zyrtarët e Presidencës, gjatë kryerjes së detyrave në lidhje me përpunimin e të dhënave në procesin e emërimit dhe betimit të prokurorit duhet të ruaj konfidencialitetin e të dhënave.
2. Dështimi për të respektuar konfidencialitetin paraqet shkak për fillimin e procedurës përkatëse në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## **KAPITULLI IV- DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 14 Regjistri**

Departamenti, mban Regjistrin e dekretëve të Presidentit për emërimin e prokurorëve.

### **Neni 15 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit me dekret nga ana e Presidentit.

**Hashim THAÇI**

**President i Republikës së Kosovës**

Prishtinë, 24 qershor 2019.

**Miratuar me Dekret Nr. 132/2019, datë 24.06.2019,  
nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi**